



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:217646

Datë: 30.12.2022

Numri i dokumentit: 03820201

**PKR Nr. 215/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda**, me kryetarin e trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.B. nga fsh. L., K. I, për shkak të kryerjes së veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda nen shenjen PP/I Nr. 185/2022 dt. 31.10.2022, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me dt. 22.12.2022, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, si dhe të akuzuarit S.B. të njëjtën dite e mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 30.12.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**S.B.** nga i ati I. dhe e ëma V.e gjinisë G., i lindur me dt. .... në fsh. L., I, ku edhe banon në rr. “S. B.” nr. ., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion menaxher në restauronin “Freskia” në Istog, i identifikuar me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

*Më parë e gjer më datën 10.06.2022 në orën 08.00 në fshatin L. K I., në garazhin e shtëpisë së tij ka mbajtur në pronësi armë në kundërshtim me nenin 5 me Ligjin e zbatueshëm lidhur me Armët Nr. 05/L -022 dhe atë: Një pushkë gjysëm automatike e kalibrit 7.62 mm, e prodhimit të panjohur me nr serik ....dhe 1 karikator i zbrazët, në atë mënyrë që me rastin e bastisjes dhe kontrollit nga zyrtarët policor sipas Urdhrit të Gjykatës Themelore-Pejë nën UGJK nr 90/22 e dt 10.06.2022, kanë gjetë dhe sekuestruar armën në fjalë për të cilin është konstatuar se nuk posedon Leje nga organet kompetente*

- me çka ka kryer veprën penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21 par. 2 38, 39 par.1 nënpar.1.2, 46 par. 1 nën par. 1.1, 47, 48, 49, 50, 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 70, 366 par.1 dhe par. 3 të KPRK-së, si dhe nenit 245,

246, 248 par. 1 dhe 4, 282 par. 2 nën par. 2.1, 360, 365, 366, 453 par.3 të KPPRK-së, të njëjtin e:

## **G J Y K O N**

- I. Me dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, te cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse ne afat te verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale, dënimi nga pika I të këtij dispozitivi, respektivisht dënimi me kusht prej 6 (gjashtë) muajsh do të zëvendësohet në burgim efektiv.
- I. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Në kuptim të nenit 366 par. 3 KPRK-së e lidhur me nenin 282 par. 2 nën par. 2.1 të KPPRK-së, të pandehurit S.B.i shqiptohet:

## **DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI**

**KONFISKOHET** një (1) pushkë gjysëm automatike kalibër 7.62mm, prodhim i panjohur me nr. serik ....si dhe një (1) karikator të cilat gjenden pranë Njësitit të Hetimeve të Stacionit Policor në Istog të evidentuar me nr. të rastit 2022-...-..., dhe të njëjtat **URDHËROHET** që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të **SHKATËRROHEN**.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 185/2022 dt. 31.10.2022 kundër të pandehurit S.B. nga fsh. L., K. Istog, për shkak të veprës penale “*Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve*” nga neni 366 par.1 të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 22.12.2022, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë Ersan Qavolli dhe i pandehuri S. B..

Pas njoftimit të të pandehurit lidhur me të drejtat e tij në procedurën penale, dhe po ashtu me ata që rrjedhin nga neni 246 par. 1 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës nuk ka angazhuar askënd, nuk ka nevojë për mbrojtës, mbrojtjen do ta jep personalisht.

Pas konstatimit të aktakuzës nën shenjen PP/I Nr. 185/2022 dt. 31.10.2022 si e lexuar, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurit S. B., gjykata është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë, kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë, është penduar shumë dhe ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërit veprime të tilla në të ardhmen.

Prokurori i shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit S.B.ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës, dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2022-...-... i dt.10.06.2022; Raporti I Oficerit N. Q. me nr te rastit 2022-...-... I dt 10.06.2022; Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit S. B. dhënë në Sektorin e Hetimeve ne Istog më dt. 10.06.2022; Vërtetimi për bastisjen e shtëpisë me nr. te gjykatës UGJK.nr.90\22 i dt. 08.06.2022 ; Fotoalbum me numër te rastit 2022-...-...; Deklarata e të pandehurit e dhënë në Prokurori me dt. 25.10.2022 si dhe shkresat tjera të lëndës dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *propozoj që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, të merret parasysh pranimi i fajësisë nga ana e të njëjtit, dhe po ashtu propozoj që të bëhet konfiskimi i armës në fjale ashtu siç është cekur në aktakuze.*

I pandehuri S.B. deklaroi në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merr parasysh rrethanat lehtësuese të potencuara nga PSH, me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës së në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, arma në fjale ka qenë jofunksionale, kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptojë dënim sa më të ulët.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPPK-së.**

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe renduese të përcaktuara e të përmendura edhe nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri në të gjitha fazat si dhe në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, sinqeritetin e tij deklarues, pendimin e tij për veprën e kryer, premtimin e tij së në të ardhmen nuk do të përsërit veprimet e tilla, mosednueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat renduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me kusht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u morr në përputhje me nenet 47, 48, 49 të KPRK-së.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale u morr në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 282 par. 2 nën par. 2.1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit Nr. 05/L-36.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr. 215/22 dt. 30.12.2022**

**Zyrtari ligjor,**  
Alan Taranish

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Dr.sc. Murat Hulaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.